




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Java Multimedia Production” SH.P.K.
Numri Unik Identifikues: 810521387
Pronar – Migjen KELMENDI

OSHMA RROKUM TV
Rr/ Mbretëresha Teutë, Taslixhe 2
Prishtinë

Ref: 1910/1260/LIC/ni

“Java Multimedia Production” SH.P.K.
Numri Unik Identifikues: 810521387
Kandidati për pronar: Sara Kelmendi
MEHMEDALIU

OSHMA RROKUM TV
Rr/ Mbretëresha Teutë, Taslixhe 2
Prishtinë

VENDIM

lidhur me ndryshimin e pronësisë, respektivisht pronarit si person fizik të OSHMA Rrokum TV– me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rrokum TV është Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizual i cili është i licencuar për transmetimin të programeve përmes rrjetit të operatorëve të shpërndarjes me seli në Prishtinë. Licenca e KPM-së për Rrokum TV është lëshuar më datën 4 dhjetor 2008, ndërsa më datën 21 dhjetor 2018, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në licenca është ripërtërirë për një afat prej dhjet (10) viteve.
3. Më datën 23 shtator 2019, pronari i OSHMA Rrokum TV z. Migjen Kelmendi ka parashtruar një kërkesë me shkrim në KPM, për ndryshimin e pronësisë, respektivisht personit fizik si pronar i Rrokum TV, dhe kalimin e pronësisë tek znj. Sara Kelmendi Mehmedaliu, e cila është vajza e tij.

Arsyetimi

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se, KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
6. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
7. Neni 15, pika 2, paragrafin 1 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës thekson: *“Për çdo nryshim në pronësi që kap më shumë se 10 të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovim me shkrim nga ana e KPM-së”*.
8. Në bazë të nenit 22, të ligjit për KPM-në, Licenca e transmetimit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdoj t'i jepet: *3.1. partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individ i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike.*
9. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t'i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t'iu dhënë një licencë”*.
10. Komisioni vlerëson se arsyeja për ndryshimin e pronësisë së Rrokum TV është se z. Migjen Kelmendi ka vendosur që në mënyrë aktive të përfshihet në jetën politike, si kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës.
11. Kandidati për pronar të Rrokum TV znj. Sara Kelmendi Mehmedaliu, përmes një deklarate, si pjesë e dokumentacionit të kërkesës për ndryshim të pronësisë, ka deklaruar se e pranon me vullnetin e saj të lirë pronësinë e Rrokum TV dhe se do të veproj në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së si dhe Ligjet tjera në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe në interes të publikut të gjerë.
12. Gjithashtu, znj. Sara Kelmendi Mehmedaliu ka deklaruar se përveç ndryshimit në pronësinë e Rrokum TV nuk do të ketë ndryshime në formatin dhe përmbajtjen e programit të Rrokum TV.
13. Komisioni vlerëson se Rrokum TV, në mesin e dokumentacionit si pjesë e kërkesës për ndryshim të personit fizik si pronarë, ka dorëzuar edhe Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit të ndryshuar ku si pronare e biznesit figuron znj. Sara Kelmendi Mehmedaliu kandidatë për pronarë të Rrokum TV.
14. Komisioni vlerëson se me ndryshimin e pronarit si person fizik të Rrokum TV emri i dhe numri i biznesit në të cilin është lëshuar licenca e këtij radio stacioni mbeten të njëjtit: Java Multimedia Production SH.P.K. me numër unik identifikues 810521387.

